

Akademiku Gudar BEQIRAJ

HAPJA E KONFERENCËS

I nderuar Shkëlqesia Juaj Zoti Filip Vujanoviç – President i Republikës së Malit të Zi,

*I nderuar Shkëlqesia Juaj Zoti Bamir Topi – President i Republikës së Shqipërisë,
I nderuar Akademik Momir Djuroviç – Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi,*

Të nderuar Zotërinj Ministra,

Të nderuar përfaqësues të pushtetit vendor,

Të nderuar të ftuar nga universitetet, institucionet shkencore e shoqëria civile,

Ju uroj mirëseardhjen në Konferencën Ndërkombëtare „Liqeni i Shkodrës-gjendja dhe perspektivat”

Kam nderin dhe privilegjin që së bashku me Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi të hapim Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: „Liqeni i Shkodrës – Gjendja dhe perspektivat”.

Njëkohësisht gjej rastin të përshëndes Presidentët e Republikës së Malit të Zi dhe Shqipërisë për vlerësimin, mbështetjen dhe pjesëmarrjen në këtë Konferencë Ndërkombëtare.

Kjo Konferencë Shkencore, ka mbledhur studiues të dy vendeve miq, që veç të tjerave i bashkon edhe Liqeni i Shkodrës, një thesar i çmueshëm për të dy qytetërimet fqinje. Studime të shumta janë kryer në këtë Liqen nga komuniteti shkencor, shoqëria civile e institucione, me programe e projekte ndërkombëtare; Akademitë respektive të Shkencave që prej vitesh kanë zhvilluar studime në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim të mbështetura nga Qeveritë. Në këtë aspekt nisma e të dy Akademive, si organizatorë të Konferencës u mbështet nga presidentët e të dy vendeve. Në Konferencë u mendua, që të synohet që krahas problemeve të shumta me të cilat përballemi sot, të nxjerrim në pah të gjitha vlerat e këtij liqe-

* Konferencë shkencore ndërkombëtare *Liqeni i Shkodrës – Gjendja dhe Perspektivat*, Podgoricë – Shkodër, 19–21 qershor 2010

ni dhe praktikat më të mira social-kulturore të njerëzve që jetojnë në brigjet e tij, (biodiversitetit, të trashëgimisë kulturore, aktiviteteve ekonomike etj.).

I pa përshkrueshëm për vlerat që ai mbart dhe unik në shumë aspekte, me një sipërfaqe rreth 380 km², Liqeni i Shkodrës është më i madhi dhe më i vjetri në Gadishullin e Ballkanit. Ai ka një breg të larmishëm, kombinim i atij të ulët, i pasur me moçale (në pjesën veriore) dhe bregut shkëmbor (në pjesën jugore).

Liqeni i Shkodrës ndahet nga Deti Adriatik nëpërmjet vargmalesh të lartë e që bashkohen në pjesën jugore nga Lumi Buna. Ai përbën një kripto-depresion, që do të thotë se në disa pjesë fundi i tij është nën nivelin e detit. Me thellësi uji që luhatet nga 8–12 m e që maksimalisht arrin deri në 45 m, Liqeni i Shkodrës prezanton një nga habitatet më interesante të rajonit, me pasuri të jashtëzakonshme ornitofaune e iktiofaune dhe me larmishmëri të admirueshme vegjetacioni uJOR. Fauna e pasur numëron: 700 lloje mikroalgash dhe 250 lloje algash; 45 lloje peshqish e 270 lloje shpendësh. Këta shpendë përbëjnë 87% të gjithë Orintofaunës të Shqipërisë. Një perlë e kësaj pasurie është padyshim edhe pelikani, si një nga zogjtë më të mëdhenj në Europë.

Brigjet e këtij liqeni të mahnitshëm bashkojnë historinë e lashtë e interesante të njerëzve që jetojnë në brigjet e tij, e mishëruar ajo në dhjetëra e qindra vepra monumentale të trashëgimisë kulturore të dy popujve. Por në të njëjtën kohë ato bashkojnë dhe interesat e një zhvillimi ekonomik të dy popujve tanë.

Eleganca arkitektonike dhe mjedisi i mbrojtur, kurora e Alpeve dhe natyra e vjrgjër i kanë dhënë një mundësi zhvillimi turizmit, i cili vlerësohet si alternativë prioritare e zhvillimit perspektiv ekonomik të rajonit.

Aspektet e veçanta shkencore e kanë bërë liqenin e Shkodrës objekt të një sërë studimesh të rëndësishme shkencore, ku Akademitë e Shkencave të Shqipërisë e Ma-lit të Zi kanë dhënë kontribute të konsiderueshme.

Me keqardhje pohojmë se shfrytëzimi i burimeve natyrore të Liqenit e të rrethinave të tij, në interes të zhvillimit ekonomik e social, nuk është bërë në mënyrë të qëndrueshme dhe praktikat e aplikuara nuk kanë qenë miqësore me mjedisin. Për pasojë vihen re ndikime negative e shpesh dëmtime të pa rikthyeshme të mjedisit e biodiversitetit. Monitorimet e zhvilluara në kuadër të studimeve të shumta të kryera në zonë bëjnë thirrje për një ndryshim rrënjësor të qëndrimit të njeriut kundrejt natyrës, për të cilat duhen aplikuar politika e strategji alternative menaxhuese të efektshme ekonomikisht, të pranueshme nga shoqëria dhe miqësore me mjedisin.

Katastrofa natyrore e këtij viti nxori në pah ekzistencën e problemeve serioze, të cilat nuk mund të zgjidhen pa kontributin e kërkuesve. Është pikërisht ky, misio-ni i kësaj konference, që duke bërë bilancin e studimeve të kryera, të hartohen plane studimi strategjikë e shumë disiplinorë për zbutjen e efekteve negative, që vijnë nga praktikat e shfrytëzimit jashtë kriterëve shkencore të burimeve natyrore, drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të rajonit.

Akademitë tona të Shkencave do jenë gjithmonë në mbështetje të komunitetit të shkencëtarëve, por dhe gjithë aktorëve që venë energjitë e tyre dhe krijojnë sinergji, për ruajtjen e këtyre pasurive dhe rritjen e kontributit në interes të zhvillimit ekonomi të dy popujve tanë, pa prishur ekuilibrat natyrorë.

Para se ta mbyll fjalën time, dua të falënderoj mbështetësit financiar që mundësu-
an realizimin e kësaj Konference Shkencore Ndërkombëtare: Ministrinë e Arsimit
dhe të Shkencës; Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe
Shoqërinë e Transportit Interurban „Klid Ballkan”.

*Duke përfunduar në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i uroj Konfe-
rencës punë të mbarë!*

